

AKT - THEMELIMI  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**Neni 1. Forma e Shoqërisë**

Sot me datë 07/01/2021, unë Rezarta Demiri, e datëlindjes 14.05.1998, shtetase shqiptare, mbajtese e leternjoftimit elektronik me Nr.032915229 dhe me Nr. Personal J85514045T, lindur dhe banuese ne Vilë Bashtovë, Njësia Administrative Gosë, Bashkia Rrogozhinë , madhore dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, bazuar në Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe në veçanti, por jo ekskluzivisht, me Ligjin Nr.9901, Datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, Ligjin Nr.9723, Datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar, Ligjin Nr.131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” si edhe me përcaktimet specifike të akt themelimit dhe të statutit, nënshkruaj Akt Themelimin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar Sh.P.K (këtu e më poshtë të njohur si "Shoqëria"), veprimtaria e së cilës do të regullohet nga baza e mësipërme ligjore .

**Neni 2. Emri i Shoqërisë**

Emri i shoqërisë është “TROPICAL FRUITS” Sh.p.k. Ky emërtim mund dhe duhet të jetë edhe emri tregtar i shoqërisë. Shoqëria do të përdorë edhe vulën e saj në të gjitha korrespondencat dhe dokumentat formale që do emetojë.

**Neni 3. Ortakët e Shoqërisë**

Shoqëria “TROPICAL FRUITS” Sh.p.k krijohet dhe themelohet si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me 1 (një) ortak të vetëm. Ortaku i shoqërisë “TROPICAL FRUITS” Sh.p.k është REZARTA DEMIRI.

**Neni 4. Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë “TROPICAL FRUITS” Sh.p.k, është në adresën: Lagjia “Qendër”, ndertesa nr.7, fshati Vilë Bashtovë, Njësia Administrative Gosë, Bashkia Rrogozhinë.

**Neni 5. Objekti i Veprimtarisë Tregtare të Shoqërisë**



Shoqëria “TROPICAL FRUITS” Sh.p.k ka si objekt të veprimtarisë së saj tregtare, por pa u kufizuar vetëm, si më poshtë vijon:

“Kultivimin dhe tregëtimin (Import/Eksport) të fruta perimeve, agrumeve dhe produkteve agroushqimore. Import eksporti i plehrave kimikë dhe produkteve të ndryshme për mbrojtjen dhe trajtimin e bimëve, fidanëve të fruta perimeve. Import eksport i fidanëve të fruta perimeve, farërave të bimëve mjekësore dhe produkteve agroushqimore Prodhimi dhe përdorimi, për nevojat e veta dhe shitja të tretëve, i impianteve dhe sistemeve të ujitjes së bimëve dhe kulturave dru frutore, me tubacione me pika. Ngritja dhe ndërtimi i baseneve ujëmbajtëse për furnizimin e impianteve vaditëse. Ngritja e strukturave, tendave dhe serave për mbrojtjen dhe mbarështimin e bimëve dhe fidanëve të kulturave dru frutore si për nevojat e veta ashtu edhe për shitje të tretëve. Ngritja e konstruksioneve industriale për përpunimin, magazinimin dhe ruajtjen e produkteve agroushqimore. Blerja ose marrja me qira e trojeve dhe terreneve bujqësore për kultivimin e fruta perimeve dhe produkteve agroushqimore. Kryerja e punimeve dhe shërbimeve, të tretëve, që nga përgatitja e terreneve, mbjellja dhe trajtimi në të gjithë ciklin e rritjes deri tek tregëtimi i prodhimit. Import eksporti i materialeve, veglave të punës, mjeteve motorrike dhe makinerive bujqësore për kryerjen e shërbimeve të kultivimit dhe mirëmbajtjes së bimëve dhe terreneve bujqësore”.

#### **Neni 6. Kohëzgjatja e Shoqërisë**


Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë së shoqërisë “TROPICAL FRUITS” Sh.p.k është e pakufizuar. Ajo fillon nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

#### **Neni 7. Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali bazë fillestar i shoqërisë “TROPICAL FRUITS” Sh.p.k është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë, tërësisht i paguar nga ortaku i vetëm i shoqërisë. Kontributi i ortakut të vetëm përbën kapitalin themeltar të regjistruar të shoqërisë, i cili përbëhet nga një kuotë e vetme që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë “TROPICAL FRUITS” Sh.p.k.

#### **Neni 8. Transferimi i Pjesëve të Kapitalit**

Pjesët e kapitalit të shoqërisë “TROPICAL FRUITS” Sh.p.k, mund t’i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit të shoqërisë.



### **Neni 9. Administrimi i Shoqërisë**

Shoqëria "TROPICAL FRUITS" Sh.p.k, administrohet nga administratori i vetëm i saj, Znj.Rezarta Demiri, e datëlindjes 14.05.1998, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit elektronik Nr.032915229 dhe Numrit Personal J85514045T, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar. Administratori i shoqërisë, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshme apo të jashtëzakonshme, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe akteve specifike të statutit të shoqërisë.

Administratorit i jepen të gjitha fuqitë e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe përmbushjet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit dhe normave në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori ka të drejtën të ndihmohet nga shërbimet e të tretëve dhe të konsulentëve të cilëve mund t'u delegojë pjesërisht ose tërësisht kryerjen e veprimeve.

Administrator është gjithashtu i autorizuar të veproje në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendres Kombetare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrimet në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e veta edhe personave të tjerë me Prokure të Posaçme.

### **Neni 9. Gjuha**

Ky akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Për të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve dhe dokumenteve të mësipërme, versioni në shqip do të jetë i vetmi version ligjërisht detyrues.

ORTAKU

i SHOQËRISË me PËRGJEGJËSI të KUFIZUAR

REZARTA DEMIRI

